

VENDIM
Nr. 437, datë 26.6.2019

PËR KRITERET E LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË PËRPUNIMIT INDUSTRIAL TË DUHANIT DHE/OSE PRODHIMIT TË PRODUKTEVE TË DUHANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim përcaktimin e kriterëve për licencimin e veprimtarive të përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit sipas standardeve të përshtatshme të cilësisë, synohet mbrojtja e shëndetit të konsumatorit dhe përmirësimi i teknologjisë në rritjen e cilësisë së produktit përfundimtar.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi, për referencë do të përdoren përkufizimet e dhëna në ligjin nr. 8691, datë 16.11.2000, “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe akronimet:

- MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- QKB – Qendra Kombëtare e Biznesit;
- AKDC – Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve.

Veprimtaritë “Përpunim industrial i duhanit” dhe “Prodhim i produkteve të duhanit” përfshihen në grupin e tretë të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, në kategorinë II. 5. C, aneksi 1, dhe vendimin nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Licencimi i veprimtarive “Përpunim industrial duhani” dhe “Prodhim i produkteve të duhanit” bëhet sipas legjislacionit për licencat. Licenca u jepet subjekteve që plotësojnë kushtet tekniko-teknologjike për përpunimin industrial të duhanit dhe/ose prodhimin e produkteve të duhanit. Verifikimi i kushteve tekniko-teknologjike kryhet nga AKDC-ja, me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

3. Përpunimi industrial i duhanit mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet, si më poshtë vijon:

3.1 Kriteretë të përgjithshme

- a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie “Përpunim industrial duhani”;
- b) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 20 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik;
- c) të vërtetohet nga organet e drejtësisë që nuk është i ndjekur penalisht.

3.2. Kriteretë teknike

- a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;
- b) zotëron ambiente të përshtatshme, jo më pak se 500 m², për magazinimin e duhanit të grumbulluar, përpunimin industrial, klasifikimin dhe magazinimin e duhanit të përpunuar, fermentimin natyral (vjetërsimin), të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje/huapërdorjeje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;
- c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit dhe klasifikimit të duhanit;

c) disponon laborator analizash ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e duhanit.

d) disponon mjete transporti në pronësi ose marrëveshje përdorimi me kapacitet jo më pak se 2 tonë, të mbuluara, të përshtatshme për transportin e gjetheve të duhanit.

dh) disponon pajisje të përshtatshme për përpunimin industrial të duhanit, jo më pak se 1 000 kg në ditë, në varësi të llojeve të duhanit që do të përpunojë, si më poshtë vijon:

- i. dhomë vakuumi;
- ii. transportierë klasifikimi;
- iii. eliminues materialesh joduhanore, më të rënda dhe më të lehta se duhani;
- iv. dhomë fermentimi;
- v. furra për tharjen dhe fermentimin industrial të certifikuar;
- vi. presë për presimin e duhanit;
- vii. pajisje për kontrollin e lagështisë dhe të temperaturës së duhanit dhe ambientit ku përpunohet;
- viii. përshkrim të teknologjisë së zbatuar.

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të tyre, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, standardi me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë, që është në fuqi, ambalazhimi dhe etiketimi.

4. Prodhim i produkteve të duhanit mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet, si më poshtë vijon:

4.1 Kriteret e përgjithshme

a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie “Prodhim i produkteve të duhanit”;

b) të vërtetohet nga organet tatimore që s’ka detyrime dhe/ose nuk është në proces falimenti;

c) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 15 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik;

ç) të vërtetohet nga organet e drejtësisë që nuk është i ndjekur penalisht.

4.2. Kriteret teknike

a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;

b) disponon ambiente të përshtatshme, jo më pak se 500 m² për magazinimin e duhanit të grumbulluar, përpunimin industrial, klasifikimin dhe magazinimin e duhanit të përpunuar, fermentimin natyral (vjetërsimin), të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;

c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit, prodhimit dhe klasifikimit të duhanit;

ç) disponon laborator analizash të vetin ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e produkteve të duhanit;

d) disponon linjë përpunimi duhani në pronësi ose marrëveshje përdorimi, si më poshtë vijon:

i. të përshtatshme për prodhimin e duhanit, jo më pak se 1 000 kg në orë;

ii. dhomë vakuumi;

iii. cilindër për kondicionimin dhe shtimin e lëngjeve;

iv. cilindër zbutës;

v. cilindër tharjeje dhe aromatizues;

vi. transportierë klasifikimi;

vii. eliminues materialesh joduhanore, më të rënda dhe më të lehta se duhani;

viii. silose përzierjeje;

ix. silose për ruajtjen e duhanit të grirë;

x. dhomë fermentimi;

xi. furra për tharjen dhe fermentimin industrial;

xii. makinë grirjeje;

- xiii. makinë paketimi;
- xiv. presë për presim duhani;
- xv. pajisje për kontrollin e lagështisë dhe temperaturës së duhanit dhe të ambienteve ku prodhohet;

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të pajisjeve, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, produkti i gatshëm dhe karakteristikat kryesore të tij, standardi, me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë që është në fuqi, ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transporti i produkteve të gatshme, afatet e garancisë dhe jetëgjatësisë së produktit, data e prodhimit.

5. Prodhim duhan nargjile (shisha) mund të kryhet nga një subjekt që vërteton se plotëson kushtet tekniko-teknologjike, si më poshtë vijon:

5.1 Kriteria të përgjithshme

- a) të jetë i pajisur me ekstrakt tregtar, me objekt veprimtarie “Prodhim i produkteve duhanit”;
- b) të vërtetohet nga organet tatimore që s’ka detyrime dhe/ose nuk është në proces falimenti;
- c) të vërtetohet nga organet tatimore pagesa e kontributeve shoqërore të jo më pak se 4 punonjësve me kohë të plotë, gjatë vitit të fundit kalendarik.

5.2 Kriteria teknike

- a) të ketë të punësuar teknolog me arsim të lartë, diplomuar në teknologji ushqimore;
- b) disponon ambiente të përshtatshme, jo më pak se 300 m², për magazinimin e duhanit të grumbulluar, të vërtetuara me dokumente pronësie apo me kontratë qiraje me kohëzgjatje jo më pak se 5 vjet;
- c) depoziton planimetri të ambienteve të magazinimit, përpunimit, prodhimit dhe klasifikimit të duhanit;
- ç) disponon laborator analizash të vetin ose ka kontratë me një laborator vendas ose të huaj për vlerësimin e duhanit;
- d) disponon mjete transporti në pronësi ose në marrëveshje përdorimi;
- dh) disponon linjë të përshtatshme për prodhimin e duhanit nargjile (shisha) jo më pak se 150 kg në orë;
- e) disponon larëse për heqjes e mbetjeve të duhanit;
- ë) disponon cilindër përzierës të duhanit me ngrohje;
- f) zotëron enë përzierëse me ngrohje për shkrirjen e glukozës;
- g) zotëron enë përzierëse me ngrohje për shkrirjen e glicerinës;
- gj) disponon enë përzierëse për aromat;
- h) disponon enë përzierëse për harmonizimin e duhanit me aromat;
- i) zotëron transportierë;
- j) zotëron makinë grirjeje;
- k) zotëron makinë paketimi;
- l) disponon pajisje për kontrollin e lagështisë dhe temperaturës.

Lista e pajisjeve, shoqëruar me foto, dhe treguesit teknikë shoqërohen edhe me planvendosjen e pajisjeve dhe përshkrimin e karakteristikave të pajisjeve, përshkrimin e teknologjisë së zbatuar, ku të përfshihen lëndët e para dhe ndihmëse, karakteristikat kryesore të tyre, produkti i gatshëm dhe karakteristikat kryesore të tij, standardi, me të gjithë treguesit cilësorë të sigurisë që është në fuqi, ambalazhimi, etiketimi, ruajtja dhe transporti i produkteve të gatshme, afatet e garancisë dhe jetëgjatësisë së produktit, data e prodhimit.

6. Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit merret pasi të jetë kryer vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar dhe pasi të shlyhet tarifa përkatëse.

Vlerësimi i të dhënave për kushtet teknike dhe teknologjinë e instaluar kryhet nga komisioni i ekspertëve pranë AKDC-së, përbërja e të cilit përcaktohet me urdhër të titullarit të këtij institucioni dhe bazohet në:

a) vlerësimin e dokumentacionit teknik, të paraqitur sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim;

b) vlerësimin në vend të mjediseve dhe nivelit teknologjik të instaluar, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

AKDC-ja shprehet me aktmiratimi ose aktmosmiratimi, jo më vonë se 10 ditë pune, të cilin ia përcjell MBZHR-së;

Në rast aktmiratimi, MBZHR-ja regjistron subjektin kërkuar në regjistrin e përpunuesve industrialë të duhanit dhe/ose prodhuesve të produkteve të duhanit dhe ia përcjell QKB-së.

QKB-ja pajis me licencë subjektin pasi të ketë marrë konfirmim bankar të pagesës së tarifës përkatëse.

Afati për marrjen e vendimit është 10 ditë pune, nga momenti i aplikimit pranë QKB-së.

Pajisja me licencë bëhet sipas formatit tip, të miratuar nga QKB-ja.

Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit është pa afat.

Licenca e përpunimit industrial të duhanit dhe/ose prodhimit të produkteve të duhanit regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave pranë QKB-së.

7. Kur, përgjatë kryerjes së veprimtarisë, ndodh ndryshim faktik i të dhënave, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, titullari i licencës duhet të njoftojë menjëherë QKB-në dhe AKDC-në.

Revokimi i licencës, përveç sa është parashikuar në nenin 29, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, mund të bëhet në çdo kohë, me kërkesë të titullarit të AKDC-së, nëse gjatë ushtrimit të këtyre veprimtarive nuk garantohet dhe/ose cenohet interesi publik.

Kërkesa për revokim i drejtohet QKB-së, bashkë me dokumentacionin shoqërues të cenimit të interesit publik.

8. Të gjithë operatorët e licencuar njoftohen për marrjen e masave për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në këtë vendim brenda një periudhe tranzitore 3-mujore. Me mbarimin e këtij afati, në zbatim të pikës 6, të këtij vendimi, AKDC-ja njofton QKB-në dhe operatorin për fillimin e procedurës së revokimit të licencës.

Vendimi nr. 126, datë 27.2.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e dhënies së lejes së përpunimit industrial dhe/ose të prodhimit të produkteve të duhanit”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe